



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Bujqësisë
Periudha raportuese	Gusht, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Shkumbin Gashi

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues

Duke u bazuar në planprogramin e punës në kuadër të Drejtorisë, brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj.

Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë planifikuara në programin e punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

- Pritet të përfundojë procesi i korrje-shirjeve në pjesën e parë të muajit gusht;
- Vazhdon aplikimi i fermerëve për subvencione dhe grante nga MBPZHR, deri më 28.08.2020;
- Planifikohen vizita në terren, tek fermerët përfitues të granteve;
- Planifikohen vizita për vlerësimin e dëmeve nga kushtet atmosferike tek fermerët e komunës së Prishtinës;
- Do të zhvillohen vizita tek fermerët përfitues të granteve dhe subvencioneve në komunën e Prishtinës;

- Do të bëhet shpërndarja e pajisjeve bletare për fermerët përfitues.

3. *AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:*

- Procesi i korrje-shirjeve ka përfunduar më 04.08.2020;
- Ka përfunduar procesi i aplikimit të fermerëve për subvencione ,të cilat jepen nga MBPZHR, më 28.08.2020;
- Brenda këtij muaji, kemi bërë gjithsejtë 22 vizita rutinore tek përfituesit e granteve nga Komuna e Prishtinës;
- Gjithashtu, janë vizituar edhe 60 fermerë të tjerë të komunës së Prishtinës për të parë për së afërmi dëmet që u janë shkaktuar nga kushtet atmosferike (breshri, shiu dhe vërshimet afër lumenjve);
- Kemi zhvilluar gjithsejtë 9 vizita tek fermerët e komunës së Prishtinës, ku kemi parë për së afërmi punët dhe aktivitetet që ata i zhvillojnë në fermat e tyre bujqësore;
- Është bërë shpërndarja e pajisjeve bletare për fermerët përfitues, ku gjithsejtë janë përkrahur 213 fermerë.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

- Do të vazhdojnë vizita për vlerësimin e dëmeve nga kushtet atmosferike tek fermerët e komunës së Prishtinës.

4.1.2. *Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese*

- Nuk janë planifikuar për këtë periudhë.

4.1.3 *Takimet me palë*

- Kemi pasur gjithsej 25 takime me palë.

5. Takimet me institucione të tjera

- Nuk kemi pasur

6. Diskutime publike/takimet me qytetarë

- Kemi pasur një diskutim publik.

6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Nuk ka pasur kërkesa të tilla.

6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

- **Gjithsej 23 lëndë.**

7. Takime të tjera

- Nuk kemi pasur takime të tjera.

8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

- Formimi i komisionit për caktimin e kriterëve për subvencione dhe grante;
- Përgatitja e thirrjeve për aplikim për subvencione në Komunën e Prishtinës;
- Procesi i përpunimit të të dhënave për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore;
- Implementimi i projektit “Furnizim me material fidanor për fermerët e komunës së Prishtinës;
- Planifikohen vizita në terren tek fermerët përfitues të granteve.

11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.